

TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Ekspert i Verifikimit të Shpenzimeve (Expenditure Verification Expert)

Institucioni përfitues: Agjencia Kombëtare e Rinisë (PP02), Shqipëri

Emri i projektit: HARMONY — “Health and Resilience: Mental Empowerment for New Youth”

Kodi i projektit: 03C1055

Programi i financimit: Interreg Europe

Instrumenti i politikës i adresuar: Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029

Data e përfundimit të kontratës: Gusht 2029 (e ndryshueshme në varësi të afateve të projektit HARMONY)

Vendi i angazhimit: Tiranë / punë në distancë sipas nevojës

Raportimi: Te Koordinatorin e Projektit, FLC dhe përfaqësuesit e partnerëve në projekt

1. Konteksti i projektit

Projekti **HARMONY**, i bashkëfinancuar nga Programi Interreg Europe, synon përmirësimin e politikave të shëndetit mendor për të rinjtë përmes shkëmbimit ndërrajonal të praktikave, forcimit të bashkëpunimit shumëpalësh dhe integrimit të mirëqenies mendore në politikat rinore në vendet partnere.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (PP02) është institucioni përgjegjës për zbatimin e komponentëve të projektit në Shqipëri, përfshirë menaxhimin financiar, raportimin dhe respektimin e kërkesave të BE-së. Për të garantuar transparencë dhe saktësi financiare, kërkohet angazhimi i një eksperti të jashtëm të specializuar në **verifikimin e shpenzimeve**, i cili do të sigurojë kontroll të rregullt të dokumentacionit financiar të AKR-së për projektin.

Pozicioni mbështet pjesën më kritike të qeverisjes së projektit, **besueshmërinë e raportimit financiar**, identifikimin e rreziqeve, përputhshmërinë me rregullat e Interreg Europe dhe mbrojtjen e interesit të institucionit.

2. Qëllimi i pozicionit

Eksperti i Verifikimit të Shpenzimeve do të garantojë:

- kontrollin e rregullt financiar të të gjitha shpenzimeve të realizuara nga AKR në kuadër të projektit;
- përputhshmërinë e dokumentacionit me rregullat e Interreg Europe;
- hartimin e raporteve të verifikimit për çdo periudhë gjashtëmujore;
- identifikimin e parregullsive, kostove të papranueshme dhe rreziqeve financiare;
- asistencën e AKR-së për minimizimin e rreziqeve;
- përgatitjen e raportit final të kontrollit, i cili mbyll financiarisht kontributin e AKR-së në projekt.

Ky pozicion është thelbësor për garantimin e integritetit financiar të projektit, mbështetjen e procesit të certifikimit nga First Level Controller (FLC) dhe ruajtjen e standardeve të larta të menaxhimit të fondeve të BE-së.

3. Detyra dhe përgjegjësi

Eksperti do të kryejë këto detyra kryesore:

A. Verifikimi gjashtëmuor i shpenzimeve

- Kontroll i brendshëm i shpenzimeve çdo 6 muaj sipas periudhave zyrtare të raportimit të Interreg Europe.
- Analizë e të gjithë dokumentacionit shoqërues: fatura, kontrata, tendera, timesheets, udhëtime, prova pagesash, dosje prokurimi etj.
- Verifikim i pranueshmërisë së çdo shpenzimi sipas rregullave të BE-së dhe buxhetit të miratuar.

B. Identifikimi i rreziqeve dhe udhëzim profesional

- Identifikim i kostove të mundshme të papranueshme ose të dokumentuara dobët.
- Dhënie rekomandimesh me shkrim për korrigjime dhe masa përmirësuese.
- Sugjerime për standardizimin e dokumentacionit.

C. Raportim zyrtar

- Përgatitja e **7 raporteve gjashtëmuore të verifikimit**, ku përfshihen:
 - përmbledhje e shpenzimeve të verifikuara;
 - analiza e pajtueshmërisë;
 - çështjet e identifikuara;
 - rekomandime të qarta;
 - sinjalizime për rreziqe financiare.
- Përgatitja e **Raportit Final të Kontrollit**, që përmbledh të gjithë ciklin financiar të projektit.

D. Mbështetje për FLC dhe partnerët e projektit

- Përgatitja e sqarimeve shtesë në rast pyetjesh nga FLC, Lead Partner ose Interreg Europe Joint Secretariat.
- Ofrimi i asistencës ad-hoc për sqarime të drejtpërdrejta financiare.

4. Kualifikime të kërkuara

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Financë, Kontabilitet, Ekonomi ose një fushë të afërt.

- Minimumi 5 vite përvojë profesionale në kontroll financiar, auditim ose verifikim të buxheteve të sektorit publik.
- Përvojë e provuar me projekte të financuara nga BE, idealisht me Interreg Europe, programe të Politikës së Kohezionit ose të ngjashme.
- Njohje e thelluar e rregullave të pranueshmërisë së kostove, procedurave të prokurimit publik dhe kërkesave të dokumentacionit mbështetës sipas granteve të BE-së.
- Njohje shumë e mirë e gjuhës angleze dhe shqipe, me shkrim dhe me gojë.
- Aftësi të forta analitike, dokumentuese dhe komunikimi.
- Aftësia për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të respektuar afatet e rrepta të raportimit.

Të gjithë ekspertët duhet të jenë të pavarur dhe të lirë nga konflikti i interesit në funksionet që kryejnë sipas kësaj kontrate.

Mjediset mbështetëse & backstopping

Kostot për mjediset mbështetëse, përfshirë backstopping-un, janë të përfshira në ofertën financiare.

Akomodimi i zyrës

Autoriteti kontraktues nuk do të ofrojë hapësirë zyre. Eksperti pritët të punojë nga ambientet e tij të punës.

Mjediset që do të sigurohen nga kontraktori

Eksperti duhet të sigurojë akses në:

- Infrastrukturë të sigurt dhe të besueshme digjitale për trajtimin e dokumenteve financiare.
- Të gjitha mjetet e nevojshme për përgatitjen e raporteve profesionale (p.sh., editorë PDF, fletë llogaritëse, softuerë menaxhimi dokumentesh).
- Mjete komunikimi për kontakt të rregullt me stafin e AKR-së (p.sh., platforma videokonferencash, email, dosje cloud).

Të gjitha mjediset duhet të vetë-financohen. Kontrata zbatohet me model çmimi global; nuk do të rimbursohen veçmas kosto të tjera për pajisje ose logjistikë.

Pajisjet

Nuk do të blihet pajisje sipas kësaj kontrate. Çdo mjet, pajisje ose softuer që përdoret për realizimin e detyrës duhet të sigurohet dhe mirëmbajët nga kontraktori.

5. Kohëzgjatja dhe vendndodhja

- Kontrata fillon në **Janar 2025 dhe në linjë me kohëzgjatjen e projektit mund të mbarojë në Gusht 2029.** (e ndryshueshme në varësi të afateve të projektit)
- Eksperti mund të punojë në distancë, por takime të herëpashershme me stafin e projektit mund të kërkohen në Tiranë.
- Të gjitha verifikimet mund të kryhen elektronikisht, duke realizuar akses të sigurt në dokumentet e projektit.

6. Dokumentet që duhet të dorëzohen

Kandidati duhet të aplikojë me:

- **CV të përditësuar** (preferohet format Europass)
- **Shprehje interesi duke argumentuar plotësimin e kritereve**
- **Kopje të diplomave/certifikatave**
- **Dokumente që dëshmojnë eksperiencën në auditim/verifikim financiar**
- **2 Referenca profesionale**

7. Mënyra e aplikimit dhe afati

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë:

 info@akr.gov.al

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **03 Janar 2026.**